



Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm

RAPORT VJETOR¹ 2020

*Ky raport paraqet në mënyrë të përmblodhur veprimtarinë e institucionit mbi zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, zbatimin i Planit të Ri-Integrit, paraqet gjithashtu veprimtarinë monitoruese dhe raportuese të institucionit, si dhe mbi kuadrin nënligjor dhe administrativ të tij. Përveç këtij raporti, Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm ka hartuar një dokument të zgjeruar të veprimtarisë së saj, të cilin do ta shpërndajë edhe me institucionet shtetërore, që marrin detyrim nga Strategjia Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm.

¹ Ky raport është një version i përmblodhur i Raportit Vjetor 2020 të Qendrës CVE

Përmbajtja

I.	Hyrje	3
II.	Zbatimi i Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm	4
III.	Zbatimi i Planit të Ri-Integrimit	6
IV.	Monitorimi dhe Raportimi	7
V.	Kuadri Nënligjor dhe Administrativ	8
VI.	Prioritete	9

Lista e grafikëve

Grafiku 1: Të dhëna mbi përpjekjet për ngritjen e kapaciteteve.....	4
Grafiku 2: Të dhëna mbi aktivitetet në kuadër të ndërgjegjësimit.....	5
Grafiku 3: Të dhëna mbi raportimet në kuadër të monitorimit.....	8

Lista e figurave

Figura 1: Prioritetet e përcaktuara për vitin 2021	10
--	----

I. Hyrje

Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (në vijim Qendra CVE) është institucioni kryesor publik për parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm e krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 737, datë 13.12.2017, si një institucion publik nën varësinë e Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë. Misioni i Qendrës është të ruajë vlerat e bashkëjetesës dhe harmonisë fetare, duke mbrojtur shoqërinë shqiptare nga ekstremizmi i dhunshëm dhe duke zhvilluar kapacitetet e aktorëve të ndryshëm kundër ekstremizmit të dhunshëm. Institucioni ynë udhëheq dhe orienton përpjekjet e institucioneve shtetërore për të zbatuar Strategjinë Kombëtare për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planin e Veprimit, si dokumenti më i rëndësishëm për t'u zbatuar në këtë drejtim.

Qendra CVE koordinon në nivel kombëtar dhe lokal ndërhyrjet ndaj komuniteteve të cenueshme në rastet e shfaqjes së radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, duke nxitur ndërhyrjet e institucioneve për rritjen e kapaciteteve të tyre në drejtim të krijimit të mekanizmave funksionalë dhe aftësimin të burimeve njerëzore të niveleve të ndryshme.

Në muajin qershor 2020, ish drejtori i institucionit dha dorëheqjen nga ky post, për t'u zëvendësuar nga znj. Lejdi Dervishi. Me marrjen e detyrës së drejtorit të Institucionit në datën 01.07.2020, znj. Dervishi ka vijuar punën e intensitet për realizimin e objektivave të institucionit, njëherazi duke theksuar vëmendjen tek objektiva të tjera me rëndësi për fushën e veprimtarisë së Qendrës siç janë:

- ndjekja e procesit të koordinimit të të gjithë strukturave shtetërore për rehabilitimin dhe ri integrimin e shtetasve të kthyer nga zonat e konflikti, njëherazi duke koordinuar punën dhe orientuar partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë mbështetës të këtij procesi, për mundësimin e mbështetjes financiare në kohën e duhur;
- bërjen prioritet të çështjes së komunikimit strategjik të Qendrës CVE, nëpërmjet nxitjes së disa iniciativave të reja të vetë Qendrës CVE, por edhe nëpërmjet ndërhyrjeve të tjera të nxitura dhe të koordinuara me partnerët mbështetës të institucionit;
- nisjen e punës për rishikimin e Strategjisë Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, nën dritën e ndryshimeve dhe zhvillimeve të reja të ndodhura gjatë viteve të fundit në shoqërinë shqiptare;
- reformimin e punës së institucionit në drejtim të ndërmarrjes së procedurave të reja administrative, logjistike dhe financiare.

Riatdhesimi i shtetasve shqiptarë nga zonat e konfliktit në Siri dhe Irak në fund të muajit Tetor 2020 (më konkretisht në datën 27.10.2020) ishte një moment kulmor i përpjekjeve intensive disa-mujore të institucioneve tona në pritjen dhe rehabilitimin e tyre me qëllim ri-integrimin e suksesshëm në komunitet.

Në tërësi, veprimtaria e institucionit gjatë vitit 2020 ka qenë tejet dinamike, në përshtatje të punës në përputhje me masat anti-COVID 19, si dhe duke shtyrë përpara agjendën e Qeverisë së Shqipërisë në parandalim dhe kundërshtim të ekstremizmit të dhunshëm.

Në materialin e mëposhtëm gjeni të pasqyruar veprimtarinë e punës së realizuar nga institucioni ynë, të ndarë në disa kategori të tilla si: ndërgjegjësimi; rritje kapacitetesh; komunikimi strategjik; bashkëpunime me partnerë në nivel kombëtar apo ndërkombëtar; procesi i monitorimit apo edhe raportimi i institucionit, si kontribut i drejtpërdrejtë në raportimin e vendit për sa i takon procesit të integritetit të vendit në Bashkimin Evropian, por jo vetëm; si dhe kuadri ligjor dhe administrativ i funksionimit të institucionit, si një domosdoshmëri për mbarëvajtjen e punës së tij.

II. Zbatimi i Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm

Strategjia Kombëtare për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm² (në vijim Strategjia Kombëtare) është dokumenti kryesor që udhëheq punën e Qendrës CVE që prej krijimit të saj. Sikurse edhe vitet e kaluara³, edhe gjatë këtij viti është punuar me zbatimin e Planit të Veprimit të kësaj strategjie, plan i cili është detajuar nga Qendra CVE në aktivitete konkrete në bashkëpunim me çdo ministri apo institucion tjetër të përfshirë.

Grafiku 1: Të dhëna mbi përpjekjet për ngritjen e kapaciteteve



Burimi: Qendra CVE, 2020

Më konkretisht, gjatë këtij viti janë ndërmarrë iniciativa dhe realizuar me institucionet shtetërore dhe aktorë të tjerë, 120 sesione informuese dhe ndërgjegjësuese me pjesëmarrjen e 1255 individëve, me qasje ndër institucionale dhe ndër sektoriale, janë realizuar 82 trajnime dhe 26 video/konferenca të cilat kontribuojnë në ngritjen e kapaciteteve me aktorë të vijës së parë, 222


²Vendimi Këshillit të Ministrave, nr. 930, datë 18.11.2015 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planit të Veprimit”.

³ Qendra u krijua me VKM nr.737, datë 13.12.2017, dhe u bë plotësisht operacionale në muajin shtator të vitit 2018.

video/konferenca ne nivel rajonal dhe ndërkombëtarë me aktorë ndërkombëtare dhe rajonalë, është punuar për fuqizimin e mekanizmave ekzistues të referimit në nivel qendror dhe vendor duke zhvilluar takime periodike me përfaqësues vendorë, anëtarë të Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike (KSVP) dhe përfaqësues të pushtetit qendror në nivel vendor, si dhe është punuar për përmirësimin e qasjes strategjike të komunikimit me publikun, si dhe për zhvillimin apo krijimin e rrjeteve të Qendrës⁴. Po ashtu, janë krijuar partneritete të tjera me rëndësi për procesin e Rehabilitimit dhe Ri-integrimit (R&R) janë zhvilluar edhe më tej partneritetet e ngritura me organizatat ndërkombëtare, si dhe.

Më poshtë shpjegohen më konkretisht veprimtaritë e realizuara nga institucioni ynë, në përmbushje të detyrimeve për zbatimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të saj të Veprimit. Këtë veprimtari, Qendra CVE e ka realizuar duke koordinuar punën dhe orientuar ministrinë e ngarkuara për zbatimin e Strategjisë, përkatësisht Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), Ministrinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve (MASR), Ministrinë e Brendshme (MB), Ministria e Drejtësisë (MD), Ministria e Ekonomisë dhe Financave (MEF), Ministria e Mbrojtjes (MM) dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ). Struktura të tjera shtetërore të përfshira në veprimtarinë e realizuar janë edhe organet e pushtetit vendor dhe agjenci shtetërore⁵. Vlen të theksohet mbështetja financiare e partnerëve të Qendrës, ka luajtur një rol ky në realizimin e kësaj veprimtarie.

Grafiku 2: Të dhëna mbi aktivitetet në kuadër të ndërgjegjësimit



Burimi: Qendra CVE, 2020

⁴ Qendra ka krijuar dhe zhvilluar Rrjetin e Organizatave të Shoqërisë Civile, Rrjetin e Komuniteteve Fetare dhe Rrjetin e medias, ndërkohë ka nisur puna për krijimin e Rrjetit të Gruas, Rrjetit të të Rinjve, Rrjetit për Kërkuesit dhe Studuesit, si dhe Rrjetit të Komunitetit të Biznesit.

⁵ Të tilla si SHISH, AKSHI, AKCESK, DSIK, AMA etj.

Qendra CVE i ka dhënë një peshë të veçantë bashkëpunimit të shkëlqyer me partnerët kombëtarë, rajonalë dhe ndërkombëtarë të tillë si SH.B.A.-të, Bashkimi Evropian, Ambasada e Mbretërisë së Holandës, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Hedayah, Këshilli i Evropës, GCERF, UNICEF, IOM, Terre des Hommes, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, SHIS, IDM, AIIS, Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza, si dhe shumë partnerë të tjerë të vyer⁶. Falë këtij bashkëpunimi është mundësuar mbështetja institucionale dhe rritja e kapaciteteve të Qendrës CVE, është mbuluar financiarisht zbatimi i dy programet të rehabilitimit dhe ri integritit⁷, po ashtu janë ndërmarrë një sërë ndërhyrjesh për rritjen e ndërgjegjësimit të strukturave shtetërore dhe aktorëve të tjerë të shoqërisë, nën qasjen e angazhimit të të gjithë shoqërisë në parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm.

Për sa i përket takon zhvillimit të Komunikimit Strategjik, një objektiv i rëndësishëm për punën e Qendrës CVE, për realizimin e të cilit janë realizuar një sërë veprimtarish dhe janë arritur një sërë rezultatesh ndër të cilat mund të përmendim hartimin e një “Strategjie Komunikimi”, në referencë të situatës së riadhesimit të të kthyerve në vend nga zonat e konfliktit; realizimin e 19 (nëntëmbëdhjetë) takimeve koordinuese mbi hartimin e “Raportit fillestar” për kryerjen e hulumtimit për realizimin e mesazheve P/CVE, të realizuara në bashkëpunim me Qendrën për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG). Gjatë gjysmës së dytë të vitit, është përmirësuar ndjeshëm komunikimi institucional me publikun mbi aktivitetet e kryera, përmes daljes publike të drejtorit të Qendrës CVE në disa emisione televizive, si dhe nëpërmjet hapjes dhe funksionimit të platformave zyrtare online siç janë kanali në YouTube dhe llogaria në Twitter⁸.

III. Zbatimi i Planit të Ri-Integritit

Vlen për t’u theksuar gjithë veprimtaria koordinuese, monitoruese dhe lehtësuese që Qendra e Koordinimit ka ndërmarrë përgjatë zbatimit të VKM-së 826, datë 26.10.2020 “*Për ofrimin e shërbimeve për pritjen dhe akomodimin e fëmijëve të pashoqëruar të kthyer nga Siria dhe Iraku*”, në kuadër të operacionit për riadhesimin e shtetasve nga zonat e konfliktit, pasi kemi një intensifikim të shumëfishtë të angazhimit të institucionit në të gjithë hallkat e procesit, njëherazi duke siguruar mbarëvajtjen e tij në çdo drejtim.

Qendra CVE, në bashkëpunim me ministritë e linjës kanë zhvilluar një punë të qenësishme parapërgatitore e cila ka konsistuar në hartimin e planeve të veprimit dhe koordinimin e hapave ndërmjet të gjithë aktorëve të përfshirë si për pjesën e rehabilitimit por edhe për ri integrimin e tyre të suksesshëm në komunitet.

Menjëherë pas vlerësimit paraprak shëndetësor të shtetasve të kthyer, u bë shoqërimi dhe akomodimi i tyre në Qendrën Pritëse të Trajtimit, strukturë e Ministrisë së Mbrojtjes, ku ata

⁶ Për më shumë partnerë të tjerë, vizitoni faqen <https://cve.gov.al/partners/>

⁷ Për më shumë informacion, shih pikën III.

⁸ Më shumë informacion mbi këtë çështje mund të gjendet në kanalet zyrtare të institucionit: www.cve.gov.al, <https://twitter.com/CenterCVE>.

qëndruan deri në vendosjen e tyre në banesa me qëllim ri-vendosjen e tyre përfundimtare në komunitet.

Në zbatim të VKM-së nr. 826, datë 26.10.2020 është ngritur Qendra Pritëse e Trajtimit të Rasteve të Rikthyer nga Siria dhe Iraku (Qendra Pritëse), në varësi të Shërbimit Social Shtetëror, e cila po punon në linjë të parë me shtetasit e rikthyer, që nga dita e parë dhe në vijimësi mbi trajtimin e nevojave për ushqim, strehim, kujdes dhe asistencë shëndetësore dhe psiko-sociale, asistencë ligjore, edukim arsimor, aktivitete rehabilituese dhe ri-integruese.


Ky proces është koordinuar në çdo hap të tij nga Qendra CVE në bashkëpunim edhe me aktorë të tjerë si IOM, Terre des hommes, dhe UNICEF. Qendra CVE përtej koordinimit, po monitoron në vazhdimësi të gjithë procesin dhe implementimin e tij për sa i përket rehabilitimit dhe ri-integrimit.

Vlen për t'u theksuar fakti se trajtimi i këtyre shtetasve po fillon të japë rezultatet e duhura, gjë që konfirmohet dhe nga punonjësit e Qendrës Pritëse, se të gjithë shtetasit kanë filluar të reagojnë pozitivisht ndaj programeve rehabilituese ditore që po zbatohen aty. Me rëndësi është fakti se të gjithë aktorët e përfshirë në pritjen dhe rehabilitimin e këtyre shtetasve janë trajnuar nga Qendra CVE mbi fenomenin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm që çon në terrorizëm, specifikisht mbi procesin parandalues dhe rehabilitues/ri-integrues.

IV. Monitorimi dhe Raportimi

Qendra CVE në kuadër të rolit të saj monitorues të institucioneve qendrore dhe vendore për sa i përket politikave dhe aktiviteteve në fushën e parandalimit të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm ka krijuar platformën online për monitorimin e Planeve të Veprimit me Ministrinë e Linjës, nëpërmjet krijimit të një programi të posaçëm, të krijuar veçanërisht dhe sipas specifikave të kërkuara nga institucioni. Për shkak të veçantisë së tij, ky program është duke u përmirësuar, duke saktësuar elemente të tij që shërbejnë për të realizuar me efektivitet monitorimin e nevojshëm.

Grafiku 3: Të dhëna mbi raportimet në kuadër të monitorimit



Burimi: Qendra CVE, 2020

Qendra CVE gjithashtu ka hartuar raportin e monitorimit, për periudhën 27 Tetor - 30 Dhjetor, të të gjitha aktiviteteve të realizuara në kuadër të procesit rehabilitues dhe ri-integrues të 5 (pesë) të riatdhesuarve të parë që po realizohet në Qendrën Pritëse të Trajtimit dhe e ka dërguar atë pranë Kabinetit të Kryeministrit.

Në kontekstin e angazhimeve për procesin e Integritimit Evropian, Drejtori i Qendrës CVE mori pjesë në takimin e 11-të Komitetit të Stabilizim-Asociimit Bashkimi Evropian – Shqipëria si dhe në takimin e 12-të të Nën-Komitetit për “Drejtësi, Liri dhe Siguri” midis BE-së dhe Shqipërisë. Një moment kulmor ka qenë edhe kontributi i Qendrës CVE në kuadër të zbatimit të Planit të Përbashkët të Veprimit për Luftën Kundër Terrorizmit BE - Shqipëri, e cila ka raportuar kryesisht mbi zbatimin e objektivit nr. 2 të këtij plani, që ka të bëjë me Parandalimin dhe rehabilitimin dhe ri integrimin e shtetasve shqiptarë nga zonat e konfliktit.

Gjithashtu, Qendra CVE ka qenë pjesë në grupin e punës për hartimin e Strategjisë Ndër-sektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021-2026 dhe Planit të Veprimit 2021-2023 si dhe Strategjisë Ndër-sektoriale për Luftën Kundër Terrorizmit 2021-2025 dhe të Planit të Veprimit 2021-2023. Të dy këto dokumente janë të një rëndësie të veçantë në kuadër të mbarëvajtjes së punës së Qendrës CVE dhe zhvillimin e aktiviteteve për parandalimin, ndërgjegjësimin dhe rehabilitim/ri integrimin.

V. Kuadri Nënligjor dhe Administrativ

Në sajë të reformimit të procedurave administrative në Qendrën CVE, janë ndërmarrë hapa të rinj në disa drejtime lidhur me akte rregullatore, që kontribuojnë drejtpërdrejt në mirëfunksionimin dhe mbarëvajtjen e punës dhe veprimitarisë së saj.

Gjithashtu, Qendra CVE ka parashikuar hartimin e Strategjisë së re për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, një dokument që është parashikuar në Planin Vjetor të Projekt-akteve për vitin 2021. Ky dokument synon të përmbledhë të gjithë eksperiencën e fituar nga Qendra CVE përgjatë këtyre 3 viteve të funksionimit të saj dhe përfshirjen e komponentëve të rinj për fuqizimin e mekanizmit të referimit (KVSP), ngritjen e kapaciteteve për profesionistët e vijës së parë, zhvillimin e protokolleve të unifikuara për zbatimin e programeve të rehabilitimit dhe ri-integrimit për shtetasit e radikalizuar dhe ata të rikthyer nga zonat e konfliktit në bashkëpunim me aktorët vendorë.

Qendra CVE gjatë vitit 2020, u fokusua edhe në hartimin e Planit Buxhetor Afatmesëm (PBA) së institucionit si dhe për herë të parë, filloi praktikat e prokurimit publik me procedurën “Blerje me vlerë të vogël” për lehtësime logjistike që i nevojiten Qendrës CVE për mbarëvajtjen e punës së saj dhe në realizimin e aktivitetit ndër- institucional.

VI. Prioritete

Qendra CVE, përgjatë vitit 2021, vlerëson si prioritete të rëndësishme të punës së saj, ndërhyrjet në drejtim të zbatimit të programeve rehabilituese dhe ri integruese që po i ofrohen shtetasve shqiptarë të kthyer nga zonat e konfliktit, si një veprimtari e parë në llojin e saj në vend. Po ashtu, do të punohet për të zbatuar veprimtaritë e planifikuara tashmë të Planit të Veprimit P/CVE, me një qasje prioritare kundrejt komunikimit strategjik që duhet të ndërmerret në këtë drejtim.

Hartimi i strategjisë së re P/CVE është një tjetër prioritet i rëndësishëm i institucionit, i cili do të kërkojë një vëmendje të shtuar, në drejtim të ndërmarrjes dhe avancimit të këtij procesi, i cili kërkon një bashkëpunim të gjerë të institucioneve relevante.

Figura 1: Prioritetet e përcaktuara për vitin 2021

PRIORITETET



Burimi: Qendra CVE, 2020

DREJTORI
LEJDI DERVISHI